



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 2, Datë 29.06.2015

PËR

MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR ZGJERIM TË RRJETIT TË
KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE TË OPERATORIT "VODAFONE ALBANIA" SH.A,
NËPËRMJET SHTIMIT TË ANTENAVE PËR 12 STACIONE BAZË

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28 të Ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", nenit 19 të Vendimit nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit" dhe Vendimit nr. 877, datë 03.10.2013 të Këshillit të Ministrave "Për përbërjen e Këshillit Kombëtar të Territorit", me propozimin e Ministrisë së Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e Lejes së Ndërtimit për zgjerim të rrjetit të komunikimeve elektronike të Operatorit "Vodafone Albania" sh.a., nëpërmjet shtimit të antenave për 12 stacione bazë, me subjekt kërkuar "Hellas Service" sh.p.k.
2. Pjesë përbërëse të këtij vendimi janë:
 - a. Dokumenti i Rregullores së Lejes së Ndërtimit;
 - b. Harta e Planvendosjes së Strukturave të 12 stacioneve bazë.
3. Ngarkohet Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike për lëshimin e Formularit të Lejes së Ndërtimit.
4. Formulari i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkuar vetëm pas pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë, për llogari të Njësive të Qeverisjes Vendore ku do të vendosen stacionet bazë.
5. Ngarkohet Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike dhe Njësitë e Qeverisjes Vendore për zbatimin e këtij vendimi.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



ZËVENDËS KRYETARE E KKT

EGLANTINA GJERMI

MINISTËR I ZHVILLIMIT URBAN



Znj. MILENA HARITO

MINISTËR SHTETI PËR INOVACIONIN DHE ADMINISTRATËN PUBLIKE

SEKRETARE E KKT

ADELINA GRECA

Adelina Greca



DREJTORE E AGJENCISË KOMBËTARE TË PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT